

**AKT THEMELIMI**  
Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
“Catrans Albania” SH. P. K.

Sot, më datë 01.07.2023 **Znj. Marina Lala** me ID I85521068W lindur në Durrës, Shqipëri, me datë 21 Maj 1988, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Catrans Albania” Sh. P. K. si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “Catrans Albania”.

Ortakë i kësaj shoqërie është **Znj. Marina Lala**.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet Znj. Marina Lala për një periudhë deri në 5 vjet. Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria “Catrans Albania” gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**Sh. P. K.**”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë “Catrans Albania” SH.P.K. është DURRES, Lagjja 17, Rruga P.Sorra, nr.pasuris 5/995, Kati i dhjete, Zona Kadastrale 8513.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Dhenie me qira dhe shitje të automjeteve
- Importim të automjeteve, pjeseve të kembimit, vajra lubrifikante
- Sherbim servisi dhe lavazh për automjete
- Sherbime ndermjetesimi dhe sipermarrjeje në fushën e ndertimit
- Sherbime ndermjetesimi në pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme
- Ushtrimin të çdo veprimtarie të ligjshme, të lejuar për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj sipas nenit 7 të ligjit tregtar nr.9901, dt.14.04.08.

**Neni 5**



Kapitali i shoqerise eshte 100 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga çdo ortak ne shoqeri ku çdo ortaku zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

Znj. Marina Lala zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 100 leke që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre ( pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta ). Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakut te saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesi i kësaj shoqërie, pasi lexoj me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjeti në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tij, e firmosi pa vërejtje.

### **ORTAKU I SHOQËRISË**

**Znj. Marina Lala**

